



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

Njoftim për shtyp

Rasti: Përftimi i kontrollit, nëpërmjet blerjes së 70% të kuotave, të shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar nga AK, shkresa me Nr.289 Prot., datë 26.04.2019 “Përqendrimi nëpërmjet Saudi Basic Industries Corporation dhe Saudi Arabian Oil Company”, ku përfaqësuesi ligjor CR Partners, ka njoftuar në lidhje me transaksionin që do të rezultojë nëpërmjet blerjes së 70% të kuotave të shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Pala Blerëse: Saudi Arabian Oil Company, është një shoqëri aksionare, themeluar sipas legjislacionit të Mbretërisë së Arabisë Saudite me Nr. regjistri kryesor 2052101150, datë 27.03.2018. Shoqëria Saudi Arabian Oil Company ushtron kryesisht të gjitha aktivitetet në lidhje me fushat e energjisë, duke përfshirë industrinë e hidrokarbureve, kimikateve, industri të tjera në lidhje me të ose plotësuese për të ose çdo aktivitet tjetër brenda dhe jashtë Mbretërisë së Arabisë Saudite.¹

Pala Shitëse: Saudi Basic Industries Corporation, është një shoqëri aksionare publike e themeluar datë 06.09.1976 sipas legjislacionit Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe është aktive kryesisht në industrinë petrokimike, plehut, hidrokarburet, hekur, çelik, alumin, industri të tjera, projekte që përbushin nevojat e shoqërisë, si lënda e parë, marketingu i produkteve brenda dhe jashtë Mbretërisë së Arabisë Saudite.²

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

¹ Regjistër Ekstrakti i shoqërisë Saudi Arabian Oil Company

² Regjistër Ekstrakti i shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.